



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:146845  
Datë: 05.06.2024  
Numri i dokumentit: 05783685

Cap.nr.1222/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga gjyqtarja individual Naime Ahmeti, në çështjen përmbartimore të kreditorëve H.S., H.M.K, S.K., R.D., Q.B., A.H. dhe B.Z, që të gjithë nga Komuna e Prishtinës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson M.G, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore-pagesë e të ardhurave, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.nr.703/21 të datës 20.06.2023, jashtë seance me datë 05.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e debitorit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.nr.703/21 i datës 20.06.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin e atakuar Cpc.nr.703/21 të datës 20.06.2023, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër aktvendimit mbi caktimin e përmbartimit Cpc.nr.703/21 të datës 05.04.2023, i marr nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe të anulohet aktvendimi i atakuar Cpc.nr.703/21 të datës 20.06.2023.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorët nëpërmjet të autorizuarit të tyre kanë paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave të lëshuara me datën 27.05.2021, lidhur me kompensimin në emër të pjesëmarrjes në mbledhje të rregullt për muajin Maj 2021. Gjykata ka lejuar përmbartimin e kërkuar me aktvendimin Cpc.nr.703/2021 të datës 05.04.2023, kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datën 12.04.2023, ndërsa me datën 07.05.2023, kreditorët nëpërmjet të autorizuarit të tyre kanë paraqitur përgjigje në prapësim. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimi si dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29, paragrafi 1, pika 1.3 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se: *“përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: faturat”*. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç janë faturat e datës 27.05.2021. Dokumentet e besueshme janë të përshtatshme për përmbartim ngase janë dorëzuar në kopje (të vërtetuara nga debitori sipas shkresës së datës 01.07.2021), në to është cekur kreditori dhe debitori, objekti dhe lloji andaj, nga kjo rezulton se dokumentet e besueshme janë të përshtatshme për përmbartim dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar duke refuzuar prapësimin e debitorit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe kontestimore dhe se dispozitivi është i paqartë dhe kundërthënës me arsyetimin. Aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv të aktvendimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktvendimit. Në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet

vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me refuzimin e prapësimit.

Pretendimi ankimor se faturat nuk paraqesin dokument të besueshëm pasi të njëjtat nuk janë të protokolluara dhe të vulosura, Gjkata e Apelit vlerëson se është pretendim i pabazuar dhe si i tillë nuk qëndron, ngase në rastin konkret faturat si dokumente të besueshme janë të lëshuara nga debitori, secila faturë është e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorit dhe nga kreditorët.

Gjkata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Cap.nr.1222/2023 me datë 05.06.2024

Gjyqtarja  
Naime Ahmeti